



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranverorë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 23 Maj 2012, në orën 10:00 salla N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Adem Grabovci, Bali Muharremaj, Afrim Hoti, dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: z.Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Bedri Hamza, Ministër-Ministria e Financave, Enver Peci – KGJK.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Mehmet Simnica-zyrtar i fushës për ekonomi, Artan Venhari dhe Albert Krasniqi- KIPRED.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 16.05.2012,**
3. **Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2011,**
4. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011,**
5. **Të Ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 16.05.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 16.05.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit Vjetor për Funkcionimin e Sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2011

Kryetari – Pyeti: a ka NJQHA standarde mbi bazën e të cilave bëjnë rekrutimin, sepse nga numri mbi 100 që dërgohen për certifikim, vetëm një ose dy prej tyre certifikohen. Pastaj është vetëm një institucion që merret me certifikimin e auditorëve "SKAK" kjo përbën monopol. Si mundet Komisioni të kontribuoj që të ketë konkurrencë në certifikimin e auditorëve. Certifikimi është në disproporcion me numrin e rekrutimeve. Cilat janë kriteret, dhe çka planifikohet që të rritet numri i auditorëve dhe ky numër të jetë cilësorë? NJQHAB ka kërkuar nga Kuvendi rritjen e numrit të stafit, dhe këtë nuk e bënë Kuvendi por mund ta bëjë Ministria e Financave. Te Komitetet e përbashkëta të auditimit në kuadër të MPB nuk përmendet policia. A nënkupton kjo se Policia e Kosovës ka Njësinë e vet audituese?

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – ZAP nuk e ka pranuar zyrtarisht Raportin. Pastaj ZAP ka një liste verifikuese të veçante me të cilën po përcjellë se çka është duke bërë auditimi i brendshëm. Ky do të prezantohet si kapitull i veçante në Raportin vjetor të auditimit. ZAP ka propozuar sa i përket zgjidhjes së përbashkët për zgjedhjen e auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Trajnimi që bëhet për auditim të brendshëm është shumë i ulët krahasuar me atë të jashtëm. ZAP po përdorë forcat vendore në lidhje me shoqatat e mëdha për auditimin e jashtëm. Normalisht tregu do të dukej më mirë nëse do të kishte konkurrencë sa i përket certifikimit, por kjo është ajo çfarë ka sot dhe tregu nuk mund të komandohet.

Bedri Hamza, Ministër-MF- Është qëndrim i Qeverisë së Republikës që Kosovës të ketë një sistem të qëndrueshëm të auditimit të brendshëm. Të arriturat e auditimit gjatë vitit 2011 janë, përgatitja e doracakut lidhur me auditimin e brendshëm, punimi i raportit vjetor të NJQHAB, realizimi i 15 takimeve me kryetaret e Komunave, certifikimi i auditorëve të brendshëm, organizimi i 11 pilot auditimeve për auditorët që nuk janë përfshirë në programin e certifikimit, trajnimi i stafit në Njësitë audituese përbrenda organizatave buxhetore, krijimi i njësisë të auditimit të brendshëm në disa njësi, mbulimi i të gjitha OB-ve me Komitete të auditimit, përkrahja e auditorëve nga menaxhmenti, rishikimi dhe miratimi i planit për vitin 2012-2014, azhurnimi i ueb faqes së NJQHAB, rritja e auditorëve të brendshëm për 10% krahasuar me vitin paraprak.

Qeveria ka miratuar këtë raport dhe të njëjtin është thënë se i dorëzohet edhe Auditorit të Përgjithshëm.

Ramiz Lladrovci – Përgëzoi ministrin për gatishmërinë dhe punën e mirë që po bënë. Sipas raportit 12 SSP edhe pse i plotësojnë kushtet për themelimin e NJAB, ato nuk kanë bërë një gjë të tillë. Cilat janë ato SSP dhe pse nuk kanë NJBA. Pastaj, kërkesa që Kuvendi të themelojë NJHA për agjensione të themeluara nga Kuvendi - cila është kërkesa lidhur me këtë dhe a ka Kuvendi mundësi për të bërë një gjë të tillë? Në dëgjimin publik të organizuar nga KDI në Mitrovicë është prezantuar shqetësimi nga kryetari se auditori i brendshëm fare nuk jep këshilla për veprimet e tij. Pra NJQHAB duhet t'ju kujtoj kryetarëve të komunave se auditori është personi që këshillon për proceset e brendshme.

Mursel Haljilji- Raporti është i kompletuar dhe shumë i mirë. Ka përmirësim dhe pyetja ka të bëjë me formimin dhe funksionimin e Komiteteve të auditimit. Në fjalinë e fundit sipas raportit "mbetet pengesë pagesa e anëtarëve të Komiteteve të auditimit, pasi që kjo po ndikon edhe në performancën e këtyre Komiteteve". Cila është pengesa lidhur me pagesën e anëtarëve të Komiteteve të Auditimit?

Armend Zemaj – Duke krahasuar me raportet e kaluara Raporti është real dhe NJQHAB ka treguar progres në realizimin e kompetencave të parapara me ligj. shihet se edhe OB-të kanë kuptuar rëndësinë e auditorëve të brendshëm. Vlerësimi është shumë pozitiv për të arriturat e NJQHAB dhe të MF-së. Ministri nuk ka lejuar që të shkatërrohen kapacitetet e brendshme siç ka ndodhur me disa OB, në të cilat për arsye politike janë larguar auditorët dhe kjo padyshim që ndikon në efektivitetin e auditimit të brendshëm. Ngritja dhe funksionimi i auditimit të brendshëm nëpër OB, shumica prej të cilave kanë avancuar në këtë drejtim edhe pse është e paqartë që KQZ e ka shuar këtë njësi, pastaj MIE nuk ka themeluar fare këtë njësi. Rekomandimet duhet të plotësohen si: sa prej OB-ve ka mbuluar NJQHAB me auditim. Te ndryshimi i stafit të brendshëm dhe rekrutimi i stafit joprofesional nuk është përmendu rekomandimi që të ruhen auditorët e brendshëm është rasti i Mamushës, Junikut dhe UP-së, ku janë larguar auditorët dhe janë rekrutuar staf i cili nuk ka ndjekur trajnimet e NJQHAB. Rekomandimi për Kuvendin nga Komisioni duhet të jetë që ta miratoj Raportin por edhe ta mbështesë këtë njësi, por a është NJQHAB duke shikuar planet që personat që ndjekin trajnimet të avancojnë në mënyrë që për këtë çështje të mos mbeten peng i trajnimeve ndërkombëtare?

Afrim Hoti- Disa SSP nuk kanë Njësi të auditimit si: MIE, KQZ, MD, ART, PSH. Cili është numri i sanksioneve disiplinore të shqiptuara ndaj autoriteteve të brendshme si pasojë e shkeljes së kornizës e cila nuk figuron në raport? Cili është plani i NJQHAB për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të auditorëve të brendshëm?

Valbona Dibra – Raporti është i përgatitur mirë dhe pasqyron një gjendje reale në sektorin e auditimit të brendshëm. Sipas këtij raporti ka ngritje në numrin e auditimeve të brendshme dhe në dhënien e rekomandimeve. Sektori i auditimit të brendshëm në Kosovë po avancohet në menaxhimin parasë publike. Pyeti: pse ka pasur shuarje të NJAB? A ka pasur hulumtim nga NJQHAB se si janë zhvilluar rastet Komunën e Junikut dhe në UP ku është ndërruar auditori i brendshëm? A janë ankuar këta punëtor në KMPK? Pse në Ministrinë e Integritetit Evropiane nuk funksionon NJAB? Kjo ministri është themeluar herët përderisa Ministria e Diasporës është themeluar vonë.

Bedri Hamza, Ministër/MF - Janë 12 OB të obliguara sipas Ligjit që të kenë Njësitë e auditimit përbrenda. Në shumicën e rasteve Njësitë shpenzuese paraqesin shqetësimin se kjo nuk mund të realizohet për shkak të numrit të limituar të punëtorëve, mirëpo në të gjitha rastet kur kanë kërkuar pozita për auditorë MF-ja ka aprovuar kërkesën. Disa OB nuk i kanë krijuar këto Njësi si MI, MD, Prokuroria e shtetit që dikur ka qenë brenda MD-së, mirëpo tani është ndarë si OB e veçantë. Është mendim i MF-së se shumica e OB-ve, këtë mund të realizojnë brenda numrit aktual të lejuar të të punësuarve.

Propozoi që Kuvendi për shërbime të caktuara të ketë 5, 7 apo 8 pozita plus për auditimin e zyrave të pavarura, që do të ishte e mundur të realizohet me një ekip të përbashkët nga vet Kuvendi dhe mos t'u lihet hapësirë që këto zyre të kenë një skemë të pavarur si për zyrtarë të auditimit, certifikues apo për zyrtarë të prokurimit, ngase numri i të punësuarve në zyrat rregullative është i limituar.

Po ashtu pagesa e anëtarëve të Komiteteve të auditimit është problem, sepse përkundër faktit se kjo për këta anëtarë përbën punë shtesë, sipas nenit 80 të LMFPP, nuk lejohet një gjë e tillë. Personalisht është i mendimit se kjo duhet të tejkalohet, ngase kjo është punë shtesë jashtë punëve të ngarkuara me kontratë pune. Ka kuadër deficitar sa i përket auditorëve, por kjo nuk mund të kryhet brenda natës. Ekziston plani i punës 2012-2014 dhe të gjitha këto janë paraparë në këtë plan. MF nuk ka informata si ka ndodhur situata në UP dhe Junik. MF-ja ka tri raporte të auditorit: raportin e Auditorit të brendshëm, Raportin e Auditorit të përgjithshëm si dhe të Njësisë shpenzuese. Qëllimi i MF-së është që të certifikoj kandidatë për të ngritur kapacitetet e auditorëve të rinj.

Kimete Arifi, NJQHAB/MF- Sa i parket funksionalizimit të Njësive audituese përgjegjës kryesore është menaxhmenti i atyre Organizatave Buxhetore. Disa nga OB që nuk kanë krijuar Njësinë e auditimit janë edhe Komunat e krijuara sipas pakos së Ahtisarit, si komuna të reja: Parteshi, Ranilluku, Leposaviqi etj. Pastaj MI, MD, Prokurori i shtetit etj.

Trajnimi për Auditim ka shkuar përmes Komisionit Evropian fillimisht vetëm për 54 auditorë, ndërsa për 59 të tjerë të pa përfshirë janë organizuar trajnime të tjera nga stafi vendor. Këtë vit parashihet se pjesa e pa përfshirë nga trajnimi i pare do të vazhdojë të trajnohen këtë vit nga Komisioni Evropian dhe do të përfshihen të gjithë auditorët që nuk janë të punësuar në sektorin publik. Arsyeja pse nuk është kryer, ka qenë mungesa e mjeteve dhe kursimi i mjeteve të Buxhetit të Kosovës,

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i

Rekomandoj

1. Të miratohet Raporti për funksionimin e sistemit të Auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës për vitin 2011,
2. Të përkrahet NJQHAB në ngritjen e kapaciteteve për auditor të brendshëm,
3. NJQHAB të trajtoj rastet e largimit të auditorëve të brendshëm nga disa Organizata Buxhetore – për të ruajtur kështu auditorët profesionist të certifikuar si dhe të ndërpritet praktika e rekrutimit të auditorëve pa përvojë,
4. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011

Kryetari – Raporti i KGJK-së është shumë pozitiv dhe ky institucion duhet të merret për shembull. KGJK ka prezantuar shkallë të lartë të përgjegjësisë si institucion.

Vlora Mehmeti, ZAP – KGJK ka ndërmarrë hapa konkret për përmirësimin e raportit nëntëmujor financiar. Shpalosjet në pasqyrat financiare ishin shpalosje adekuate në lidhje me çështjet financiare në pasqyra. KGJK është i gatshëm që të punojnë në menaxhimin më të mirë financiar. Megjithatë janë identifikuar mangësi në prokurim, të cilat janë pranuar nga KGJK-ja dhe janë zotuar për hapa konkret për përmirësimin e gjendjes. Këtë vit është funksionalizuar NJAB dhe KA. Janë dhënë rekomandime konkrete nga auditori i brendshëm dhe ka përkrahje nga menaxhmenti. Këtë vit ZAP është të mbështetur edhe në punën e auditorit të brendshëm.

Enver Peci –KGJK- KGJK është përpjekur t'i korrigjoj të gjitha fushat të cilat nuk janë vlerësuar mirë nga raporti i ZAP-it. Vlen të theksohet zëvendësimi i zyrtarit të prokurimit me një person tjetër. Po ashtu vërehet se ka një të arritur nga viti i kaluar në kontest të përmirësimit të të gjeturave nga ZAP-i në fushën e prokurimit, dhe në fusha të tjera, pothuajse një pjesë e rekomandimeve janë në formën e sugjerimeve.

Ramiz Lladrovci – KGJK duhet përshëndetur për punën e bërë. Raporti është shumë i mirë megjithatë pjesa që ka të bëjë me menaxhimin financiar në prokurim ka vend për përmirësim. Janë 205 vende të paplotësuara edhe pse janë të miratuara me buxhet. Pyetje: a jeni në proces të plotësimit të këtyre vendeve?

Valbona Dibra- Është fakt i mirë që raporti i KGJK-së është me opinion të pakualifikuar me gjithë disa mangësi që janë paraqitur në këtë raport. Lidhur me investimi për riparimin e Gjykatës në Skenderaj dhe Pejë, pyeti: pse nuk është bërë riparimi në Gjykatën e Skenderajt dhe a është paraparë me plan të prokurimit për vitin 2012?

Murselj Haljili – KGJK ka bërë progres krahasuar me vitin e kaluar. Edhe ZAP ka bërë një punë të mirë në këtë rast. ZAP ka të gjetur për shpenzim i buxhetit në kuadrantin e fundit dhe kjo ka të bëjë me funksionimin në mënyrë më të mirë. A ka identifikuar KGJK problemin dhe a është në drejtim të zgjidhjes së këtyre çështjeve?

Armend Zemaj – KGJK në media është prezantuar shumë keq. Dhe nga Raporti i ZAP-it shihet se gjendja është shumë e mirë në KGJK. KGJK në këtë vit ka realizuar të pritshmen, sepse KGJK ka respektuar ligjin dhe kjo duhet të thuhet me zë, se ky institucion duhet të prezantohet si OB që ka bërë progres brenda një vit fiskal. Nga anëtarët e Komisionit është ngritura disa herë çështja se auditimi duhet të bëhet duke marrë për bazë edhe natyrën e institucionit. Gjykatat kanë administratorin, kështu që Kryetari i Gjykatës komunikon me administratorin dhe një administrator i një Gjykatë nuk mundet t'i adresohet KGJK-së për furnizim për shembull për "një toner", por kjo çështje duhet rregulluar nga sekretariati i KGJK-së me akte nënligjore. Auditori duhet të ketë këto njohuri, edhe pse në rastin konkret ZAP-i ka përdorur raportin e auditorëve të brendshëm dhe ka konstatuar të gjetura që duhet përmendur. Rekomandimet e ZAP-it duhet të jenë konkrete, sepse e gjetura mos-realizimi i kontratës me specifikat e kontraktuara nuk përkon me rekomandimin, pastaj rekomandimi që ka të bëjë për blerjet me paratë e imta etj.

Bali Muharremaj - Pyeti: kur do të largohen rrethojat nga oborri i Gjykatës së Suharekës?

Albert Avdiu-KGJK - Të dhënat sa i përket të gjeturave të Auditorit janë të sakta në shumicën e rasteve, edhe pse në disa raste KGJK ka pasur mospajtime. Kufizimi në numrin e punëtorëve është njëra nga pengesat që KGJK-ja nuk ka arritur të zbatojë të gjitha rekomandimet plotësisht, dhe kjo mund ta dëmton funksionimin normal të sistemit në KGJK. Këtë vit KGJK nuk ka mundur të rekrutojë 5 gjyqtar, për shkak të pozitave për zyrtaret e tjerë, që deri tani janë paguar nga një donacion norvegjez.

Kufizimi i numrit të punëtorëve nënkupton edhe mos rekrutimin e stafit bashkë me pozitën e gjyqtarëve, ngase puna këtu është e përbashkët gjyqtar me staf mbështetës.

Të gjeturat në fushën e prokurimit: Sa i përket shumës prej 10,000 euro si e gjetur e auditorit edhe vet KGJK ka pasur dilema me zyrtarin e prokurimit, dhe është sugjeruar se këtu duhet të veprohet ndryshe. Lidhur me këtë KGJK i është drejtuar KRPP-së, e cila është përgjigjur pasi është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik. Me përgjigjen e KRPP-së është thënë se KGJK ka bërë shkelje.

Te Gjykata në Gjakovë që ka qenë rasti për vendosjen e një serveri, ndërsa janë vendosur dy serverë. Në kushte normale nuk është dashtë të ndodhë kjo. Në këtë rast është vepruar në kundërshtim me atë se çka në fakt është kërkuar nga KGJK-ja.

Tek e gjetura e tretë ka mos pajtime me zyrtarin e ZAP-it, Sa i përket çështjes së tremujorit, ngase tre mujori llogaritet prej kohës së nënshkrimit të kontratës.

Rasti i Gjykatës së Skenderajt - është ajo çka ka ndodhë. Atij operatori ekonomik nuk i është bërë pagesa për atë shërbim. Zhvendosja e investimit është bërë pa njoftim zyrtarë, dhe për KGJK-në nuk është obligim ligjor pagesa e operatorit nëse nuk ka bërë marrëveshje për zhvendosje të investimit.

Shpenzimi i buxhetit në tre mujorin e katërt – KGJK është munduar të bëjë planifikimin në baza tre mujore, mirëpo këtë nuk e ka arritur për shkak të anulimit të tenderëve shumë shpesh. Po ashtu për vitin 2011 vetëm 60% e buxhetit të shpenzuar në kapitale, është realizim i ulët, dhe arsyeja është për shkak të vonësive në aktivitetet e prokurimit. Numri i kufizuar i operatorëve ekonomik. Shpenzimi i parësë së imte për KGJK-ne duhet të rishikohet.

Të hyrat vetanake me anë të marrëveshjes së mirëkuptimit për vitin 2011, shuma është mbi 1.2 milion euro, mirëpo për vitin 2012, ato hyjnë në buxhet në shumën totale dhe nuk ka nevojë të ketë marrëveshje të mirëkuptimit për të hyrat vetanake.

Çështja e rrethojave në objektet e Gjykatave - ekspertët e sigurisë kanë rekomanduar që të ketë rrethoja dhe përderisa ekziston kjo kështu, duhet për të patur rrethojat në Objektet e Gjykatave.

KGJK ka punuar në planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Raporti i auditimit të Pasqyrave Financiare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2011, nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

5. Të Ndryshme

a). Mbledhja e radhës e Komisionit

Kryetari - Njoftoi anëtarët e komisionit se Ministri i MZHE-së ka kërkuar që mbledhja e datës 30 Maj 2012, të shtyhet për datën 31 Maj 2012 ose 01 Qershor 2012. poashtu njoftoi anëtarët e Komisionit se ka kërkuar nga MZHE që të dërgoj informacione lidhur me

Ramiz Lladrovci – Tha se forma e komunikimit të MZHE-së përmes shesheve të kabinetit është e pa-pranueshme. Në komunikim duhet ruajtur niveli dhe shkresa është dashur të nënshkruhet nga ministri për kryetarin e Komisionit.

Armend Zemaj – Ndau mendimin me deputetin Ramiz Lladrovci dhe tha se duhet ikur praktikave të këqija të komunikimit.

Albert Kinolli – Është shumë e rëndësishme që të respektohet mënyra e komunikimit, por dua t'ju njoftoj e me datë 01 Qershor 2012 mbahet mbledhje plenare kështu që opcionale mbetet data 31 Maj 2012.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Mbledhja e planifikuar për datë 30 Maj 2012, shtyhet për kohë të pacaktuar.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu